

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**QERSHOR – DHJETOR 2025****DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE BERAT**

Nr.	Data e rregjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
28	02.06.2025	Kërkesë për vërtetim nëse banesa e ndodhur në lagj. Dëshmorët e Kombit. është apo jo monument kulture	02.06.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Berat, ju informon se banesa objekt kërkesë, e ndodhur në lagjen “Dëshmorët e Kombit”, nuk gëzon statusin pasuri kulture dhe nuk është e klasifikuar si “monument kulture”, referuar Vendimeve e Urdhërave të Ministrisë së Kulturës mbi shpalljen e objekteve monument kulture. Gjithashtu banesa nuk është pjesë e zonës së mbrojtur të Qendrës Historike të qytetit të Beratit. Jepet ky vërtetim me kërkesë të qytetarit për efekt dokumentacioni pranë ASHK Berat.	E plotë	Jo
29	05.06.2025	Kërkesë për qeramosje çatie të banesës, lagjja Goricë.	23.06.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj, specialistët e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Berat, realizuan inspektimin në terren të banesës suaj, e cila nuk gëzon statusin pasuri kulture por ndodhet brenda Qendrës Historike Berat. Banesa paraqet problematika në cati. Ju informojmë se në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, çdo ndërhyrje në pasuritë kulture apo në zonën e mbrojtur të saj duhet të realizohet vetëm pasi të jetë hartuar një projekt nga një subjekt i licencuar për hartimin e projekteve për objektet	E plotë	Jo

				<p>“monument kulture”, i cili më pas duhet të miratohet nga Këshilli Teknik apo Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Tiranë.</p> <p>DRTK Berat merr përsipër hartimin dhe miratimin e projektit pranë instancave përkatëse. Për efekt dokumentacioni për hartimin e projektit, lutemi të na vini në dispozicion një kopje të dokumentacionit të pronësisë që dispononi për banesën si dhe duhet të paraqiteni pranë zyrave tona për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikimin e projektit.</p>		
30	05.06.2025	Kërkesë për sistemim të oborrit të banesës, monument kulture kat.II.	23.06.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për sistemin e oborrit në banesën tuaj, e cila gëzon statusin pasuri kulturore “monument kulture kategoria e II-të në lagjen Goricë, ju informojmë se:</p> <p>Në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore apo në zonën e mbrojtur të saj duhet të realizohet vetëm pasi të jetë hartuar një projekt nga një subjekt i licencuar për hartimin e projekteve për objektet “monument kulture”, i cili më pas duhet të miratohet nga Këshilli Teknik apo Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Tiranë.</p> <p>Në bazë të verifikimit në terren, rezulton se në oborrin e banesës suaj janë kryer disa punime ndër vite pa miratimin nga instancat përkatëse. Në projektin e hartuar duhet të parashikohen dhe eliminimi i punimeve të sipërpërmenduar.</p>	E plotë	Jo
31	09.06.2025	Kërkesë nga poseduesi, i banesës monument kulture kat.II., lagj. Goricë per disa problematika : 1.Prishje e portes hyrëse	11.07.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Berat, realizoi inspektim në banesën suaj, e cila gëzon statusin pasuri kulturore “monument kulture kategoria e II-të në lagjen Goricë.</p> <p>Për të shqyrtuar ankesën tuaj, i jemi referuar fotove kronologjike të realizuara ndër vite, pasi nuk disponojmë</p>	E plotë	Jo

	<p>dhe spostim i saj ne nje vend tjetër.</p> <p>2.Përvetësim i tokës publike.</p> <p>3.Fqinji ka hapur kanalizime brenda pronës sime.</p> <p>4. Fqinji tjetër ka marre toke nga oborri dhe ka bërë kuzhine pa leje.</p>		<p>materiale grafike në arkivën tonë. Është bërë kërkesë dhe në arkivin e IKTK Tiranë, por jemi informuar që nuk disponojnë materiale arkivore. Nga krahasimi i fotove, mund te shprehemi se dera qe ju aksesoni banesën tuaj aktualisht mund të jetë realizuar në vitin 1974. Duke qënë se këto punime janë kryer shumë vite më parë, dhe për shkak të mungesës së dokumentacionit arkivor nuk mund të shprehemi për mënyrën se si është realizuar ndryshimi i aksesit për në banesë. DRTK Berat nuk disponon dokumenta arkivore që kanë të bëjnë me planimetrinë e oborreve, kufijtë e pronësisë të banesave në qendrën historike, cka e bën të pamundur saktësimin nga ana jonë nëse është zaptuar prona publike. Lidhur me pretendimin se fqinji juaj ka kryer punime pa leje në pronën tuaj, nga konstatimi në terren rezulton një ndërtim me element tulle i realizuar vite më parë. Por, duke qënë se nuk disponojmë materiale grafike për këtë banesë, nuk mund të vërtetojmë nëse është ndërtim pa leje apo jo. Përsa i përket ankesës suaj se këto punime janë kryer në oborrin tuaj, DRTK Berat nuk ka kompetencat ligjore për tu shprehur në lidhje me kufijtë e pronësisë.Nga verifikimi në banesën tuaj, u konstatua se në murin e banesës së fqinjit tjetër ka disa element metalik të mbështetur në mur dhe janë realizuar tuba shkarkimi e punime me materiale jo të përshtatshme. Sic e përmendëm dhe më lart, DRTK Berat nuk ka kompetencat ligjore për tu shprehur në lidhje me kufijtë e pronësisë.Gjithashtu, nga vizita në terren rezulton se dhe në banesën tuaj janë kryer disa punime me materiale jo të përshtatshme, për të cilat nuk disponojmë dokumenta që të vërtetojnë se janë realizuar me miratimin e instancave përkatëse.</p>	
--	---	--	--	--

32	12.06.2025	Kërkesë për restaurimin e shkallëve të drurit ne objektin monument kulture kat. II, lagjja Kala.	25.06.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, specialistët e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Berat, realizuan inspektimin në terren të banesës suaj, e cila gëzon statusin pasuri kulturore “monument kulture kategoria e II-të në lagjjen Kala. Shkallët e brendshme paraqiten të demtuara dhe porta hyrëse për në banesë paraqet dëmtime pjesore.</p> <p>Ju informojmë se në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore apo në zonën e mbrojtur të saj duhet të realizohet vetëm pasi të jetë hartuar një projekt nga një subjekt i licencuar për hartimin e projekteve për objektet “monument kulture”, i cili më pas duhet të miratohet nga Këshilli Teknik apo Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Tiranë.</p> <p>DRTK Berat merr përsipër hartimin dhe miratimin e projektit pranë instancave përkatëse. Përsa i përket ndërhyjes, DRTK Berat do realizojë punime mirëmbajtëse në portën hyrëse. Ndërsa për shkallët e brendshme për momentin e kemi të pamundur të ndërhyjmë.</p>	E plotë	Jo
33	19.06.2025	Kërkesë per qeramosje çatie, lagjja Mangalem, monument kulture kat.II.	11.07.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore apo në zonën e mbrojtur të saj duhet të realizohet vetëm pasi të jetë hartuar një projekt nga një subjekt i licencuar për hartimin e projekteve për objektet “monument kulture”, ose nga institucionet e specializuara, i cili më pas duhet të miratohet nga Këshilli Teknik apo Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Tiranë.</p> <p>DRTK Berat merr përsipër hartimin dhe miratimin e projektit pranë instancave përkatëse. Për aplikimin që do kryhet në sistemin E-Leje, na nevojitet certifikata e</p>	E plotë	Jo

				pronësisë dhe kartela e pasurisë e rifreskuar.		
34	23.06.2025	Kërkesë për riparimin e murit rrethues të baçes se objektit monument kulture kat. II, lagjja Goricë.	11.07.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, specialistët e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Berat, realizuan inspektimin në terren të banesës suaj, e cila gëzon statusin pasuri kulturore “monument kulture kategoria e II-të në lagjen Goricë. Muri rrethues i banesës suaj paraqitet i degraduar dhe ka nevojë për ndërhyrje restauruese.</p> <p>Ju informojmë se në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore apo në zonën e mbrojtur të saj duhet të realizohet vetëm pasi të jetë hartuar një projekt nga një subjekt i licencuar për hartimin e projekteve për objektet “monument kulture”, i cili më pas duhet të miratohet nga Këshilli Teknik apo Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Tiranë.</p> <p>Në cilësinë e poseduesit të pronës ju lind e drejta të kryeni punime duke respektuar procedurën e përcaktuar në ligjin e sipërpërmendur. DRTK Berat mund të marr përsipër hartimin dhe miratimin e projektit pranë instancave përkatëse. Për efekt dokumentacioni për hartimin e projektit, lutemi të na vini në dispozicion një kopje të dokumentacionit të pronësisë që dispononi për banesën si dhe duhet të paraqiteni pranë zyrave tona për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikimin e projektit.</p>	E plotë	Jo
35	07.08.2025	Ankesë për disa problematika të banesës ngjitur në proçes restaurimi, lagjes -13 Shtatori.	11.08.2025	Në përgjigje të ankesës suaj, specialistët e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Berat kanë kryer inspektim në banesën objekt kerkese, e cila nuk gëzon statusin pasuri kulturore, por ndodhet brenda zonës së mbrojtur të Qendrës Historike - Berat. Punimet që po	E plotë	Jo

				<p>kryen në këtë banesë janë në kuadër të zbatimit të projektit “Rikonstruksion dhe ngritje kati i tretë i objektit”, i miratuar nga IKTK Tiranë me vendimin nr.168 datë 13.03.2025. Nga inspektimi në terren rezulton se punimet janë duke u kryer në përputhje me projektin e miratuar.</p> <p>Shtesa e katit është pjesë e projektit në përputhje me rregulloren për këtë zonë. Referuar certifikatës së pronësisë, kolonat mbështetëse të banesës janë brenda kufirit të pronës të këtij objekti. Në projekt është parashikuar vendosja e ulluqeve perimetral në të gjithë çatinë për të disiplinuar ujrat e saj.</p> <p>Duke qënë se objekti ndodhet në zonën e mbrojtur të qendrës historike, DRTK Berat do të vijojë me monitorimin e zbatimit të punimeve.</p>		
36	11.08.2025	Kërkesë për qeramosje çatie të objekti monument kulture, kategoria e II-te, lagjja Goricë.	18.08.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore apo në zonën e mbrojtur të saj duhet të realizohet vetëm pasi të jetë hartuar një projekt nga një subjekt i licencuar për hartimin e projekteve për objektet “monument kulture”, i cili më pas duhet të miratohet nga Këshilli Teknik apo Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Tiranë. Duke qënë se plani i punës për vitin 2025 është hartuar në fillim të vitit, DRTK Berat mund të marr përsipër vetëm hartimin dhe miratimin e projektit pranë instancave përkatëse gjatë vitit 2026. Pas miratimit të projektit, duhet të merrni masat për zbatimin e tij me një subjekt të licencuar sipas ligjit të trashëgimisë kulturore.</p> <p>Ju sjellim në vëmendje se çdo ndërhyrje e realizuar pa miratimin e instancave përkatëse konsiderohet ndërhyrje e kundraligjshme dhe sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.</p>	E plotë	Jo

37	13.08.2025	Kërkesë e banorëve të Qendrës Mesjetare per : -Spostim i ndricuesit ekzistues për shkak te pengesës së levizjes se kembesoreve (makinave). -Rregullim kalldremi ne pjeset e demtuara.	09.09.2025	Në vijim të komunikimit tonë të mëparshëm, lidhur me problematikën e kalldrëmit përpara banesës me kod arkivi T-09, ju kemi informuar që kjo ndërhyrje do realizohet gjatë vitit 2025. Përsa i përket kërkesës suaj për spostimin e ndriçuesit ekzistues të ndodhur mbrapa Teqesë së Helvetive, ju informojmë se ndricimi i Qendrës Mesjetare është realizuar në bazë të një projekti të miratuar dhe ndriçuesi është vendosur në një truall shesh ku nuk pengohet lëvizja e këmbësorëve. DRTK Berat do marrë masat në vijim dhe për riparimin e kalldrëmit të dëmtuar gjatë punimeve për përmirësimin e infrasktrukturës nëntokësore në rrugicën pas Teqesë së Helvetive.	E plotë	Jo
38	03.09.2025	Ankesë per ndertim pa leje te dritareve ne murin e perbashket me fqinjin.	08.09.2025	Në përgjigje të ankesës suaj, në lidhje me hapjen e disa dritareve në banesën pranë tuajës, specialistët e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Berat, realizuan përsëri inspektim në terren dhe ju informojmë si më poshtë: Rezulton se banesa objekt kërkesë gëzon statusin pasuri kulturore “monument kulture, kategoria e dytë”, e ndodhur në lagjen Kala, Berat, identifikuar me kod arkive K-009/a. Në arkivën e institucionit tonë për këtë banesë ka një projekt me emërtimin “Projekt rikonstruksioni dhe përshatje i banesës K-009/a, lagjja Kala, Berat”, miratuar me Vendimin Nr. 7, dt. 06.10.2011 të KKR., i cili është zbatuar në vitin 2011. Duke krahasuar gjendjen aktuale të banesës, rezulton se projekti parashikon hapjen e tre dritareve në fasadën me orientim lindor të banesës, por aktualisht janë hapur katër dritare, pra vetëm njëra prej dritareve është në kundërshtim me projektin. Për këtë arsye, në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për	E plotë	Jo

				Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, DRTK Berat ka informuar me shkresë zyrtare poseduesin e banesës duke i kërkuar të marrë masa për hartimin e një projekti ku të parashikohet eliminimi i gjithë problematikave të konstatuara.		
39	24.09.2025	Kërkesë për qeramosje çatie te baneses monument kulture kat.II., lagj. Goricë.	09.10.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj në lidhje me qeramosjen çatisë së banesës, identifikuar me kod arkive G-070/1, e cilia gëzon statusin pasuri kulturore “monument kulture, kategoria e dytë”, lagjja Goricë, Berat, specialistët e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Berat, realizuan inspektim në terren dhe ju informojmë si më poshtë:</p> <p>U konstatua se çatia e banesës përveç problemeve që ka më mbulesën, mund të ketë edhe probleme në strukturë, gjithashtu edhe materiali drusor i strehës së çatisë është mjaft i dëmtuar. Nga verifikimi në terren, krahasuar me kronologjinë e fotove të vjetra, u konstatua se në pjesën e përpame të banesës është realizuar një strehë dhe shkallë metalike, si dhe në oborrin e saj ekziston një ndërtim i cili mund të jetë realizuar pas viteve 1990. Rezulton se këto ndërhyrje janë realizuar pa miratimin e instancave përkatëse, pasi në arkivën e DRTK Berat nuk ka dokumentacion mbi realizimin e tyre.</p> <p>Ju informojmë se nuk është kompetencë e institucionit tonë të japë leje për realizimin e ndërhyrjes së parashtruar në kërkesën tuaj, për këtë arsye duhet të merrni masa për të respektuar kuadrin ligjor të sqaruar në vijim.</p> <p>Në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore apo në zonën e mbrojtur të saj do të realizohet vetëm pasi të jetë hartuar një projekt nga një subjekt i liçensuar për hartimin e projekteve për objektet</p>	E plotë	Jo

				<p>“monument kulture”, i cili më pas duhet të miratohet nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Tiranë.</p> <p>Nga ana juaj duhet të merren masa për hartimin e projektit ku përveç ndërhyrjeve të nevojshme për mirëmbajtjen e objektit, duhet të parashikohet edhe eliminimi i ndërhyrjeve të kundraligjshme të konstatuara. Projekti aplikohet në sistemin e-leje dhe më pas shqyrtohet e miratohet nga KKTKM.</p> <p>Ju sjellim në vëmendje se çdo ndërhyrje e realizuar pa miratimin e instancave përkatëse konsiderohet ndërhyrje e kundraligjshme dhe sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.</p>		
40	02.10.2025	Kërkesë për restaurim dhe qeramosje çatie, banese monument kulture kat.II., lagj. Kala,	16.10.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, specialistët e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Berat, realizuan inspektim në terren të banesës suaj, e cilia gëzon statusin pasuri kulturore “monument kulture, kategoria e dytë” me kod arkive K-110, lagjja Kala, Berat. Nga vizita e realizuar u konstatua se çatia e banesës ka probleme konstruktive, fasada është e dëmtuar, elementët drusorë si dyer e dritare janë degraduar.</p> <p>Ju informojmë se në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore apo në zonën e mbrojtur të saj do të realizohet vetëm pasi të jetë hartuar një projekt nga një subjekt i licencuar për hartimin e projekteve për objektet “monument kulture”, i cili më pas duhet të miratohet nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Tiranë. Nga ana juaj duhet të merren masa për hartimin e projektit nga një subjekt i licencuar, ku përveç restaurimit të çatisë të parashikohen edhe ndërhyrjet e tjera të nevojshme.</p> <p>Çdo ndërhyrje e realizuar në kundërshtim me kuadrin</p>	E plotë	Jo

				ligjor të mësipërm, konsiderohet ndërhyrje e kundraligjshme dhe sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.		
41	22.10.2025	Kërkesë për punime të brendshme në objektin dyqani në rreshtin e parë të dyqaneve Mangalem.	21.11.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, lidhur me ndërhyrjet që doni të realizoni, në objektin monument kulture kategoria e dytë ndodhur në lagjen Mangalem, ju informojmë se në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe VKM Nr. 823 date 28.12.2023, çdo ndërhyrje me karakter mirëmbajtës dhe restaurues në objektet monument kulture duhet të realizohet vetëm pasi të jetë hartuar një projekt nga një subjekt i licencuar për hartimin e projekteve për këtë kategori punimesh, i cili më pas duhet të miratohet nga Këshilli Teknik Tiranë ose KKTKM Tiranë.</p> <p>Në vijim ju duhet të marrni masa për hartimin e një projekti ku do të pasyrohet ndërhyrja që doni të realizoni, i cili më pas do të aplikohet për miratim pranë instancave përkatëse. Vetëm pas miratimit të projektit, mund të vijoni me zbatimin e ndërhyrjes nga një subjekt i licensuar sipas ligjit të trashëgimisë kulturore.</p> <p>Gjithashtu ju sjellim në vëmendje se çdo ndërhyrje e realizuar pa plotësuar kriteret e parashtruara më sipër, konsiderohet ndërhyrje e kundraligjshme dhe sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.</p>	E plotë	Jo
42	29.10.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të dokumentacionit juridik mbi punimet që u kryen në murin e banesës monument kulture kat.II, lagj. Kala.	06.11.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Berat, ju informon si më poshtë: Nisur nga ankesat e vazhdueshme të fqinjtit, specialistët e DRTK Berat në muajin maj të vitit 2024, realizuan një verifikim në terren, ku konstatuan nevojën për ndërhyrje në dy muret kufizues të oborrit të banesës së fqinjtit tuaj. Muri në anën lindore kishte pësuar thyerje të trarit lidhës dhe rrezikohej shembja e tij, ndërsa në murin në anën</p>	E plotë	Jo

				<p>jugore u identifikuan shkëputje të gurëve në kreun e tij. Duke qënë se herë pas here shkëputeshin gurë nga krerët e mureve, me qëllim shmangjen e incidenteve të mundshme dhe ruajtjen e strukturës së mureve, DRTK Berat, në cilësinë e institucionit të specializuar si dhe në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, hartoi projektin ku parashikoi ndërhyrjet mirëmbajtëse të nevojshme, i cili u miratua nga Këshilli Teknik, Tiranë me vendim Nr.13 datë 10.09.2024.</p> <p>Projekti që parashikonte vetëm zberthimin e muraturës së dëmtuar, pastrimin e mureve dhe riparimi i tyre duke ruajtur lartësinë ekzistuese të të dy mureve, u zbatua nga punëtorët e mirëmbajtjes së DRTK Berat. Theksojmë se ndërhyrja e realizuar konsistoi në mirëmbajtjen e strukturës së mureve për të shmangur incidente të mundshme si pasojë e shembjes së tyre. Bashkëlidhur gjeni kopje të projektit dhe vendimin e miratimit.</p>		
43	04.11.2025	Kërkesë për riparim çatie, në objekt monument kulture kategoria e dytë, lagjja Mangalem.	17.12.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, specialisti i Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Berat, realizoi inspektimin në terren të banesës suaj, e cila gëzon statusin pasuri kulture “monument kulture kategoria e II- të, identifikuar me kod arkive M-120. Nga konstatimi në terren rezulton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në një prej dhomave çatia e banesës është rrëzuar. Ka lëvizje të tjegullave dhe në disa zona tjegullat janë thyer. 2. Streha e çatisë është dëmtuar dhe në disa pjesë është kalbur materiali drusor. 3. Tavanet e banesës janë dëmtuar për shkak të lagështisë. <p>Ju informojmë se në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, çdo ndërhyrje në pasuritë kulture apo në zonën e mbrojtur të saj duhet të</p>	E plotë/ Kthyer përgjigje përtej afateve pasi kërkuesi nuk është rezident në qytetin e Beratit. Konstatimi në terren për trajtimin e kërkesës u realizua në momentin	Jo

				<p>realizohet vetëm pasi të jetë hartuar një projekt nga një subjekt i liçensuar për hartimin e projekteve për objektet “monument kulture”, i cili më pas duhet të miratohet nga Këshilli Teknik apo Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Tiranë.</p> <p>DRTK Berat merr përsipër hartimin dhe miratimin e projektit pranë instancave përkatëse. Pas miratimit të projektit, në bazë të buxhetit që do akordohet për vitin 2026, do shqyrtojmë mundësinë e realizimit të ndërhyrjes.</p> <p>Për efekt dokumentacioni për hartimin e projektit, lutemi të na vini në dispozicion një kopje të dokumentacionit të pronësisë që dispononi për banesën.</p>	që kërkuesi u paraqit në banesë.	
44	09.12.2025	Kërkesë për punime të brendshme në tualetin e banesës monument kulture kat.II, lagj. Kala.	10.12.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se në zbatim të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore apo në zonën e mbrojtur të saj duhet të realizohet vetëm pasi të jetë hartuar një projekt nga një subjekt i liçensuar për hartimin e projekteve për objektet “monument kulture”, i cili më pas duhet të miratohet nga Këshilli Teknik apo Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Tiranë.</p> <p>Gjithashtu, në vijim të komunikimit tonë të mëparshëm, ju rikujtojmë që duhet të merrni masat për hartimin e një projekti ku të parashikoni dhe eliminimin e ndërhyrjeve pa leje të realizuara ndër vite në banesën tuaj.</p> <p>Ju sjellim në vëmendje se çdo ndërhyrje e realizuar pa miratimin e instancave përkatëse konsiderohet ndërhyrje e kundraligjshme dhe sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.</p>	E plotë	Jo